



Ne baze te neneve 12, paragrafi 2, shkronja (c), 17 paragrafi 1, shkronja (o), të Ligjit Nr-03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008”), nenit 7, pika (2) të Ligjit Nr-04/L-071, për Sistemin e Adresave “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-29/2011”, neneve 15, paragrafi 1, shkronja (o), 29, paragrafi 2, shkronja (d), te Statutit te Komunës se Suharekës, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008, Kuvendi i Komunës në Suharekë në mbledhjen e mbajtur me datë, 23.11.2018, miratoi këtë:

## V E N D I M

### Për formimin e komisionit për emërtimin e zonave të qarkullimit publik

#### Neni 1

Me këtë vendim formohet komisioni, bartës të procesit në emërtimin e zonave të qarkullimit publik të cilat janë të pa emërtuara në territorin e Komunës së Suharekës në përbërje:

1. Reshat Selimaj-----anëtar
2. Bashkim Ndracaj-----anëtar
3. Jeton Rrakaqi-----anëtar
4. Laureta Tafaj-----anëtare
5. Osman Selimaj-----anëtar

#### Neni 2

Detyra e komisionit është të përgatis dhe përcjell procesin e emërtimit të zonave të qarkullimit publik të cilat janë të pa emërtuar në tërë territorin e Komunës së Suharekës, nga lista e emrave rezervë e cila është e miratuar nga Kuvendi i Komunës së Suharekës .

#### Neni 3

Obligohet Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim që komisionit ti ofroi materialin sipas nevojë dhe të marrë pjesë aktive në proces të emërtimit të zonave të qarkullimit publik, ashtu siç është e definuar me Ligjin Nr-04/L-071, për Sistemin e Adresave, publikuar në “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-29/2011”.

#### Neni 4

Komisioni pas përfundimit të proceduarve që janë të parapara me Ligjin Nr-04/L-071, për Sistemin e Adresave, publikuar në “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-29/2011”, përgatit tabelën e emërtimeve sipas vendbanimeve nga lista emrave rezervë dhe i rekomandon Kuvendit të Komunës në Suharekë për miratim.

#### Neni 5

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit Nr-03/L-040, për vetëqeverisjen lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008”, nenit 8, të Rregullores (QRK), Nr-01/2016, për shqyrtimin administrativ te akteve të Komunave dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen e Komunës.

## KUVENDI I KOMUNËS –SUHAREKË

01-Nr-016-74588  
Me datë 26.11.18

